

AKT THEMELIMI DHE STATUT
PËR KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TË SHOQERISË
"MAKLEV COMMUNICATION" SHPK

Sot, më datë 27/08/2021 ky Akt Themelimi dhe Statut u përpilua nga ortaku i vetëm themelues:

Z. Maringlen FLAGA, i biri i Gëzimit, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë me 01.05.1982 dhe banues në Tiranë, Rr. Asim Vokshi, Nd.71 , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i ID me nr. Karte 036789071 dhe nr. Personal I20501343J ;

deklaron se ka themeluar shoqerinë **"MAKLEV COMMUNICATION" SHPK**, me përbajtje si më poshtë vijon:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
Emërtimi, Forma Juridike, Zyra Qendrore, Kohëzgjatja, Objekti

Baza Ligjore

Në këtë statut:

- "Ligji" referues është Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërите tregtare";
- Ligji 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- "Statuti" është dokumenti i vetëm ligjor i shoqërisë, ku përcaktohet në mënyrë specifike rregullimi i veprimtarisë dhe organizimi i shoqërisë;

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **"MAKLEV COMMUNICATION" SHPK.**

Neni 2

Forma Juridike

2.1. Shoqëria **"MAKLEV COMMUNICATION" SHPK.**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (mëposhtë e quajtur "Shoqëria").

2.2. Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

2.3. Shoqëria **"MAKLEV COMMUNICATION" SHPK** është një kompani, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.



Neni 3
Zyra Qendrore

3.1. Shoqëria e ka zyrën qëndrore në adresën: **Rruga « Begir Luga », Pallati 24, Njësia Nr. 2, Tiranë**

3.2. Shoqëria në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi, mund të ndryshojë zyrën qendrore të saj, duke hapur zyra përfaqësie, degë, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
Objekti

4.1. Objekti i shoqërisë do të jetë Ofrimii i të gjitha shërbimeve që lidhen me "Call Center" dhe Contact Center duke përfshirë edhe përpunimin e të dhënavë të shoqërive të tjera dhe/ose enteve publike, ndërmjetësim tregetar dhe marketing në fushën e shërbimeve telematike dhe telefonike, veprimtaritë e lidhura dhe të ngjashme me ato të renditura më siper. Call Center, kryerjen e shërbimeve të shitjes së produktit me anë të video-call, telefonatave dhe me anë të telemarketing etj. Import-eksport, shitje - blerje mallrash, si dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me objektin e mësipërm, kryerjen e shërbimeve përkatëse në lidhje me to. Shoqëria mund të kryejë për përbushjen e qëllimeve të saj çdo lloj operacioni tregtar, mund të blejë/marrë dhe japë me qira/përdorim pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, t'i hipotekoje pasuritë e disponuara prej saj. Mund të lidhë marrëveshje dhe të kryeje veprimitari bisnesi me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objekt veprimitarie për të realizuar fitime ne fushën e aktivitetit te saj. Import-eksport, prodhim, transport e tregtim për të tretët të të mirave për llogari të saj ose të porosítësit. Të marrë pjesë në ankande apo prokurime publike të zhvilluara nga organet përkatëse shtetërore sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Të blejë/ përfitojë (përmes dhurimit apo mënyrave të tjera ligore) kuota, aksione, pjesë të kapitalit të shoqërive të tjera. Të marrë kredi apo mjetë të tjera financimi nga banka apo institucione të tjera financiare.

Neni 5
Kohëzgjatja

5.1. Kohëzgjatja e veprimitarisë së shoqërisë është me afat të pacaktuar.

5.2. Veprimitaria e shoqërisë fillon me regjistrimin në regjistrin tregtar të QKR.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

6.1. Kapitali fillestari i shoqërisë është 1000 (njëmijë) lekë, tërësisht i nënshkruar dhe shlyer nga ortaku i vetëm themelues përpara regjistrimit në QKR.



- 6.2. Kapitali është ndarë në 1 (një) kuotë, secila me vlera nominale 1000 (njëmijë) Lekë.
- 6.3. Pjesa e kapitalit zotërohet nga ortaku i vetëm z. Maringen FLAGA, zotërues i 1 (një) kuote të kapitalit themeltar, pra 100 % të tij, me vlerë 1000 (njëmijë) lekë.
- 6.4. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)
- 6.5. Shoqëria mund të zgjedhojë dhe rrisë kapitalin vetëm nëpërmjet vendimit të Ortakut të vetëm.

Neni 7

Zmadhimi dhe zgjelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zgjelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zgjelimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Zgjelimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale.

Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjeter.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në çdo rast kalimi i kuotave do të bëhet me kontratë notoriale me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin paraprak nga asambleja e ortakëve të shoqërisë.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIM-MARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organet kryesore të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve
- Administratori

Neni 10

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

Të drejtat dhe detyrimet

10.1. Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

10.2. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat epermendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 11

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare".



- Asambleja e përgjithshme thirret gjithmone nëpërmjet një njoftimi me shkresë Njoftimi me shkresë duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- Kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 12

Kuorumi

- Në të gjitha rastet kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të marrë vendime, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm(personalist apo votojnë me shkresë.) të 3/5 e ortakëve.
- Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 13

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me unanimitet mes ortakëve pjesëmarrës, për çështje si:

- ndryshimin e statutit,
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar
- shpërndarjen e fitimeve,
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 14

Përfaqësimi në Asamble

- Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 15

Administrimi

1. Asambleja e përgjithshme emëron një person fizik si administrator i Shoqërisë. Afati i emërimit të administratorit është maksimumi 3 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Ai/ajo qëndron në detyrë deri në momentin e shkarkimit ose pranimit të dorëheqjes nga Asambleja. Administratori do të ushtrojnë të gjitha kopetencat sipas parashikimeve të nenit 9 të Ligjit.
2. Administrator mund të emërohet edhe një person, që nuk është ortak i Shoqërisë.
3. Administratori mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për aktë të veçanta ose kategori aktesh.
4. Administrator i parë i Shoqërisë, duke filluar nga themelimi i saj, për një periudhë 3 (tre) vjeçare me të drejtë rizgjedhje, do të jetë:
5. Maringlen FLAGA, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 01.05.1982, identifikuar me ID me Nr. Personal I20501343J.

Neni 16

Kompetencat e administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruanë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Neni 17

Përgjegjësitet

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1.

- të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;
- të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet, gjithashtu:

- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) u kthen ortakëve kontributet;
- e) jep kredi.

Neni 18
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

Neni 19
Bilanci i shoqërisë dhe dividentët

1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.
2. Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes ose jo të dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.
3. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
 - a. aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b. shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Neni 20
Ekspertët

Eksperti Kontabël emërohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

Neni 21

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi

i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likujdatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likujdim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk merrin një vendim për emërimin e likujduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likujdues.

Neni 22

Likujduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likujdues, përvçese kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likujduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likujduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likujduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likujduesi i nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit/eve.

Neni 23

Të drejtat e detyrimet e likujduesit

1. Detyra e likujduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likujduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", likujduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likujduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likujdimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.
4. Likujduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likujdimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likujdimit zgjat më shumë se një vit, likujduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 24

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor nën juridikcionin e së cilët shtrihet aktiviteti i shoqërisë.

Neni 25

Largimi i ortakut

Ky statut nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakëve për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakë në bazë të dispozitave përkatëse të legjislacionit tregtar në fuqi.

Neni 26

Dispozita përfundimtare

Gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut do të rregullohet nga legjislacioni tregtar në fuqi dhe ligje të tjera të lidhura me të, në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ky statut do të shërbejë si dokument i vetëm i themelimit të shoqërisë.

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplarë me përbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe dhe u miratua në parim dhe nen për nen nga Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë tregtare z. Maringlen FLAGA.

ORTAKU I VETËM THEMELUES

Maringlen FLAGA

A handwritten signature in blue ink that reads "Maringlen Flaga" above a stylized signature of the same name.